



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:579/25 Datë: 27.05.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 137 të mbajtur më 19.05.2025, mori:

V E N D I M

I. Riakreditohet programi i studimit i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):

- *Biznes dhe Menaxhment BSc 180 ECTS, (me dy specializime), me kuotën maksimumi 120 studentë për vit akademik.*
 1. *Banka, Financa dhe Kontabilitet 60 studentë për vit akademik.*
 2. *Menaxhment dhe Ndermarresi 60 studentë për vit akademik.*

II. Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.

III. Obligohet Universiteti “Isa Boletini” që deri më datë 30.09.2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.

IV. Obligohet Universiteti “Isa Boletini” të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet me vendim nga KShC.

V. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.

VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Biznes dhe Menaxhment 180 ECTS, (me dy specializime) BSc;</i> 1. Banka, Financa dhe Kontabilitet 60 studentë për vit akademik. 2. Menaxhment dhe Ndermarresi 60 studentë për vit akademik.	Qazim Tmava Esat Durguti Bashkim Bellaqa Filloreta Kunoviku Demiri

Me qëllim të vlerësimit të programit të studimit, AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- 1. Për programin e studimit; Biznes dhe Menaxhment 180 ECTS, (me dy specializime) BSc** vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Goran Oblakovic, Rainer Harms është organizuar më 03.03.2025 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2), Substancialisht katër (4), dhe Pjesërisht një (1) fusha të standardeve.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 137-të, të mbajtur më datë 19.05.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtoj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë ;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Hazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë